



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**VENDIM**  
**Nr. 606, datë 23.12.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Objekti: Dërgim i çështjes në gjyq.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, etj.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Sami Ujkashi dhe Florin Demollari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; Objekti: “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr.69 viti 2021, në ngarkim të të pandehurve {...} dhe {...} të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhja me dhunë”, kryer në

bashkëpunim, “Mbajtja pa leje i armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 139, 278 dhe 25 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Nenet 283/2 dhe 134/2 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Durrës, Irida Kacerja dhe Anita Mici, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 76-28, 89 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E APELIT TIRANË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje” dhe “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.

### **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 114/2 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**